



VENDIM

Nr. 10, Datë 27.01.2016

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 157, DATË 28.12.2015 TË
BORDIT TË ERE “PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË
RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16; 99; 109 pikat 4 dhe 5; 110 pika 2 të Ligjit nr. 43/2015, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Proedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 27.01.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me një ndryshim në vendimin nr. 157, datë 28.12.2015, të Bordit të ERE-s “Për miratimin e një ndryshimi në Rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike”,

Konstatoi se :

- MEI ka shprehur qëndrimin me shkresën nr. 8379/1 Prot., datë 08.01.2015. Mbështetur në Nenin 10 të ligjit nr. 43/2015 Për sektorin e energjisë elektrike, pika 2 e tij: “*ERE bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për energjinë (MEI) dhe institucionet e tjera publike, për sa u takon çështjeve objekt të ligjit*”.
- OSHEE sh.a. ka shprehur qëndrimin e saj, dhe propozuar shtyrjen e afatit të implementimit të ndryshimit të Rregullave të Tregut siç propozuar me vendimin nr. 157, datë 28.12.2015.
- Në nenin 99 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike” parashikohet se: “*Çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike.*”
- Në nenin 98 të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se është OST sh.a përgjegjës për t’i propozuar ERE-s Rregullat

e Tregut të Energjisë elektrike të cilat duhet të jenë në harmoni me Modelin e Tregut.

- Në nenin 97/3 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike” parashikohet se është Këshilli i Ministrave organi përgjegjës që miraton Modelin e Tregut, pas propozimit të tij nga Ministria e linjës.
- Ndërkohë ende nuk kemi të miratuar një Model të Tregut të Energjisë elektrike në bazë të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike.”

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë një ndryshim ne Vendimin Nr. 157, Datë 28.12.2015 të Bordit të ERE duke ndryshuar pikën 1 të tij si më poshtë :

“Me hyrjen në fuqi të Rregullave të Tregut të energjisë elektrike pas miratimit të Modelit të Tregut në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike sipas legjislacionit në fuqi.”

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a, KESH sh.a dhe OST sh.a, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.